



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 236, Datë 02.11.2018

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S, NR. 179, DATË 08.11.2017,  
“MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT  
NATYROR” ALBGAZ SH.A.”**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, nenit 113, pika 3, të Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, neneve 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të “Rregullores për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin nr. 100, datë 05.08.2015 të Bordit të ERE dhe ndryshuar me vendimin nr. 129, datë 31.10.2015, si dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 02.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, Datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albغاز sh.a”,

**Konstatoi se:**

Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, certifikoi shoqërinë “Albغاز” sh.a si Operator i kombinuar i gazit natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC.

Shoqëria “Albغاز” sh.a nuk ka përmbushur kërkesat e vendimit sipërcituar si vijon:

Pika 2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Albغاز sh.a të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE tek Këshilli Mbikqyrës i kompanisë me antarë të cilët nuk janë të punësuar tek MIE ose tek kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

Pika 3. Albغاز të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për regjistrimin e asetëve të transmetimit dhe t’a përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të Vendimit Përfundimtar.

Pika 4. ....Paragrafi “ si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i Vendimit të Certifikimit të Albغاز sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës nr.73/2009 të Komisionit Europian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”

Pika 5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në Opinionin e Sekretariatit, Albgaz sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me:

5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimit, Albgaz sh.a. do të paraqesë ERE provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i Albgaz sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur janë efektive.

Pika 7. Albgaz sh.a., do të raportojë çdo 3 muaj në tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në vijim të sa më sipër, shoqëria Albgaz sh.a në pamundësi për të plotësuar kushtet e vendosura në vendimin ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 233/7 Prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 deri në datën 10.04.2019 dhe bën me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në këtë vendim. Albgaz sh.a argumenton se shkak për mosplotësimin në kohë të kushteve të sipërpërmendura janë vonesat administrative nga institucionet e tjera si ZRPP, MIE etj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Afatet e përcaktuara në pikat 2;3;5;5.2 dhe 7 të dispozitivit të vendimit nr. 179, datë 08.11.2018, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz sh.a, të shtyhen deri në datën 10.04.2019.
2. Afati i përcaktuar në pikën 4, paragrafi “.....si dhe duhet që të hartojë dhe t'i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i Vendimit të Certifikimit të Albgaz sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës nr.73/2009 të Komisionit Europian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” , shtyhet deri në datën 10.04.2019.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të përcjellë këtë vendim pranë “Albgaz” sh.a; Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë; Autoritetit të Konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**